

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dalip Bega kryetar, Biljana Rexhiq dhe Mejreme Zekaj-anëtare, me pjesëmarrjen e bashkpuntores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Zukë SH. Xhemajli nga f.Metehi,K.Podujevë, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë- dega në Podujevë- divizioni për Kundërvajtje, Regj.nr.8005/12-2, të datës 06.09.2013, në bazë të nenit 31 al. 3, 39 konform neni 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më 06.11.2013, merr

## A K T V E N D I M

Ankesa e paraqitur është e BAZUAR.

NDRYSHOHET aktvendimi i ankimuar, ashtu që ndaj të pandehurit Zukë Xhemajli PEZULLOHET procedura kundërvajtëse në vështrim të nenit 198.2 e lidhur me nenin 11 al. 1,2 dhe 3 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, ngase i pandehuri e ka përmbushur obligimin e përcaktuar para se të merret aktvendimi mbi kundërvajtjen gjegjësisht para se ndaj tij të filloj procedura kundërvajtëse.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

## A R S Y E T I M

Gjykata Themelore Prishtinë-dega në Podujevë- divizioni për Kundërvajtje, sipas aktvendimit Regj.nr.8005/12-2, të datës 06.09.2013, të pandehurin Zukë Xhemajli, e ka shpallur përgjegjës sepse, më dt.01 Mars deri më 31 Mars 2012 nuk e ka përmbushur obligimin ligjor që parashihet për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë- dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 17 par. 1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe në vështrim të nenit 9 të LK, i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 300.-€, duke e obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5.-€.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri ka paraqitur ankesë për shkak të:

- shkeljes së të drejtës procedurale,
- shkeljes së të drejtës materiale, dhe
- shkeljeve së të drejtës ligjore.

Në arsyetim të ankesës përpos tjerash thekson se aktvendimi i ankimuar është i kundërligjshëm dhe jo i drejtë, se nuk ka pas mundësi reale për ta dërguar formularin me kohë, por sidoqoftë të njëjtin formular e ka plotësuar dhe dërguar më dt.13.04.2012 kështu që konsideron se nuk është fajtor,etj. andaj propozon që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet dhe ky si i pandehur të lirohet nga përgjegjësia për kundërvajtje dhe dënimi i shqiptuar.

Kolegji vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, aktvendimin e ankimuar, deklarimin e të pandehurit të dhënë në seancën e shqyrtimit pranë gjykatës së shkallës së parë më datë 28.02.2013, nga deklarimi i dëshmitarit Agron Behrami-përfaqësues i AKK, nga Vërtetimi në emër të Zukë Xhemajli për dorëzimin e formularit për deklarimin e pasurisë të datës 13.04.2012, por duke u bazuar edhe në shkresat tjera të lëndës, andaj ka gjetur se ankesa e paraqitur është e bazuar.

I pandehuri në deklaratën e dhënë në gjykatë më datën 19.06.2012 thekson pos tjerash se e ka pranuar formularin për deklarimin e pasurisë të cilin e ka plotësuar me vonesë kohore të shkurtër, më dt.13.04.2012, kur edhe e ka dorëzuar pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit gjë të cilën e dëshmon përmes vërtetimit të lëshuar nga Agjencia të datës 13.04.2012. Konstatohet gjithashtu se Agjencia kundër Korrupsionit më datën 24.07.2012 ka ushtruar kërkesë për

KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	Nr. Prot:
Dip:	R. Prot:
Dip:	Pr. No:
Nr. llog:	Dip.:
Broshura:	U. llog.:
Nr. pages:	Nr. llog.:
APK/DMP	03-95/14
02	10-01-2014

